



In medias res

Arsimi në funksion të zhvillimit të shoqërisë së fortë qytetare

“Aftësia e një populli dhe e njerëzve në përgjithësi, që të nxënë, dhe atë që e kanë mësuar sa më parë ta zbatojnë në jetën praktike, si dhe që dijen ta shndërrojnë në aktivitete është çështje kruciale për zhvillimin e ekonomisë globale e cila gjithnjë e më shumë bazohet në dije dhe informacion”

James Wolfenson

Qendra për Arsim e Kosovës, në shumë aspekte është duke kontribuar që Sistemi i Arsimit të Kosovës të transformohet në një instrument të fuqishëm të zhvillimit të një shoqërie të fortë qytetare, sepse shoqëria e fortë qytetare është çelës i demokracisë së vërtetë.

Nga studimet e bëra nga kjo qendër, si dhe studimet tjera meta-analitike në botë, po dëshmohet gjithnjë e më shumë një lidhje e fuqishme korelative ndërmjet efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të arsimit në përgjithësi dhe të atij primar dhe sekondar në veçanti, me zhvillimin e ekonomisë globale.

Qendra për Arsim e Kosovës angazhohet që secili qytetarë i Kosovës të jetë si një “tip i pronës” së kapitalit njerëzor (që ka dije, aftësi dhe shkathtësi, të cilat ai i zbaton në praktikë, zbatimi i të cilave sjell ndryshime të fuqishme në ekonomi, kulturë, shëndetësi, sport, shkencë, teknologji etj).

Qytetari si “pronar” i kapitalit njerëzor e rritë produktivitetin e punës dhe bënë që fati i asnjë qytetari të mos përcaktohet nga: vendi ku ka lindur, mosha që e ka, besimi apo feja të cilës i takon, gjuha që e flet, bashkësia apo raca të cilës i përket.

Qendra për Arsim e Kosovës, po ashtu angazhohet dhe bënë përpjekje të kontribuon që secili qytetarë i Kosovës të jetë edhe “pronar” i kapitalit social. Kjo do të thotë se qytetaret e Kosovës do të jenë të aftë të lidhen në rrjete dhe partneritete të fuqishme njerëzore në të cilat respektohen vlerat, normat njerëzore, etika profesionale, ku secili qytetar i ka karakteristikat më të mira deontologjike (deontologjia është teoria mbi punën dhe detyrat e punës në profesionet dhe fushat e caktuara të jetës së njerëzore).

Për të bërë qytetarët “pronarë” të kapitalit njerëzor dhe social, Kosovës i duhet të krijojë, një Arsim cilësor për të gjithë, pavarësisht nga prejardhja etnike, racore, fetare, gjuhësore etj.

Përmes hartimit dhe koordinimit të punës në hartimin e strategjive zhvillimore për arsimin para-universitar, arsimin e lartë, integrimin të komunitetit RAE përmes komponentit të edukimit, strategjisë nacionale për avancimin e përsheptuar të të drejtave të fëmijës.

Qendra për Arsim e Kosovës është duke promovuar në praktikë Arsimin cilësor për të gjithë.

Nëpërmjet trajnimit të mësimitdhënësve të edukimit parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë për metodologji të mësimitdhënies, të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, edukimit për luftimin korrupsionit, edukimit ndër dhe multikulturor, për qeverisje dhe udhëheqje, jemi duke kontribuar që të ndodhë një ndryshim thelbësor në mendësinë e njerëzve për rolin dhe rëndësinë që ka arsimimi për zhvillimin e Kosovës dhe të integrimin të saj në vendet e zhvilluara dhe demokratike.

Shkroi: Halim Hyseni

Gjithashtu, Ministri i Drejtësisë Z. Jonuz Salihaj, ndau mirënjohje për Qendrën për Arsim e Kosovës (KEC), për bashkëpunimin dhe ndihmën profesionale të vazhdueshme që ka dhënë për “Shtëpinë Korrektuese” të Lipjanit. Në fund pas shpërndarjes së dhuratave u shfaq edhe një dramë e përgatitur nga OJQ “Qeshu-Smile”, nën udhëheqjen e Z. Avni Dalipi.

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit dhjetor është bërë certifikimi i 1325 mësimitdhënësve, të cilët kanë vijuar trajnimet në kuadër të Programit të MKLSH-së gjatë vitit 2006. Mësimitdhënësit që morën pjesë në trajnim ishin nga mbarë Kosova dhe ata u trajnuan në grupe prej 30 mësimitdhënësve. Trajnimi i një numri kaq të madh të mësimitdhënësve u mundësua falë bashkëpunimit të KEC me MASHT, KFOS, Njësinë Menaxhuese të Bankës Botërore, KFOR Italian, OJQ “Vizioni i Ri” nga Gjakova, si dhe me Drejtorinë e Gjimnazit “Zenel Hajdini” në Gjilan, 40 mësimitdhënës të së cilës e kanë vetëfinancuar trajnimin.

■ Po ashtu gjatë muajit dhjetor janë certifikuar dhe 40 mësimitdhënës për nivelin e dytë të certifikimit në kuadër të Programit të MKLSH-së. Performanca e këtyre mësimitdhënësve në klasë si dhe dosjet që ata kanë prezantuar kanë qenë material i mjaftueshëm për t’u certifikuar për nivelin e dytë.

■ Më 18-19 dhjetor është mbajtur seminari i tretë në kuadër të Programit të MKLSH-së për 40 mësimitdhënës të Shkollës Filllore “Hasan Prishtina” në Prishtinë, të cilët e vetëfinancojnë programin e trajnimit, ndërsa në të njëjtën kohë është mbajtur edhe seminari i dytë për 30 mësimitdhënës të Gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë.

Hap pas Hapi

■ Me 7 dhjetor 2006 është mbajtur takimi me personat kontaktues të institucioneve parashkollore në kopshtin “Pëllumbat e Paqes” në Pejë. Temë e takimit ishte Harmonizimi i Kurrikulit me Metodologjinë Hap pas Hapi. Takimi ishte shumë frytdhënës dhe u cilësua nga edukatorët si një ndihmesë shumë e madhe për punën e tyre në klasë.

■ Me 15-18.12.2006 u mbajt moduli i tretë (trajnimi për trajnerë) i trajnimit Edukimi për të Drejtën Shoqërore. Trajnimin e mbajtën Nancy Jane Smith nga SHBA dhe Peter Repisky nga Sllovakia. Në fund të trajnimit u shpërndanë certifikata për të tre modulet e këtij trajnimi. Certifikimi i pjesëmarrësve u bë nga Shoqata Ndërkombëtare e Hap pas Hapit (ISSA). Me këtë edhe përfundoi cikli i trajnimeve për Programin Edukimi për të Drejtën Shoqërore.

Programit ACCESS Microscholarship

■ Në dhjetor përfundoi semestri i parë i mësimit të gjuhës angleze në kuadër të Programit ACCESS Microscholarship . Këtë program që financohet nga Zyra Amerikane, janë duke e vijuar nxënësit e shkollave të mesme të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Mësimi organizohet nga mësimitdhënës nga Amerika. Ky program përveç se ka për qëllim mësimin e gjuhës angleze, po shërben edhe si rrugë për bashkëpunim ndërkulturor dhe ndëretnik midis këtyre të rinjve.

Në këtë fundvit janë organizuar dy aktivitete të përbashkëta shoqërore me grupin e nxënësve nga Prishtina dhe F. Kosova. Gjatë këtyre aktiviteteve, nxënësit janë shprehur shumë të kënaqur me programin.

Përgatiti: Petrit Tahiri